



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---



**STRATEGJIA**  
**2020 –2023**  
**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

**Prishtinë, Dhjetor 2019**

# PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                       |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>FJALA E KRYETARIT .....</b>                                                                                                        | <b>3</b>  |
| <b>HYRJE.....</b>                                                                                                                     | <b>4</b>  |
| <b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>                                                                                                    | <b>5</b>  |
| 1. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale dhe administrative në funksion të zbatimit të Ligjit të Konkurrencës;.....                    | 5         |
| 2. Promovimi i politikave të konkurrencës; dhe .....                                                                                  | 5         |
| 3. Realizimi i obligimeve që dalin nga procesi i Integrimit Evropian. ....                                                            | 5         |
| <b>Vizioni .....</b>                                                                                                                  | <b>6</b>  |
| <b>Misioni .....</b>                                                                                                                  | <b>6</b>  |
| <b>VLERAT DHE PARIMET E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS.....</b>                                                                          | <b>7</b>  |
| Transparenca dhe bashkëpunimi .....                                                                                                   | 7         |
| Integriteti dhe paanshmeria .....                                                                                                     | 7         |
| Cilësia .....                                                                                                                         | 7         |
| Efikasiteti dhe efektiviteti .....                                                                                                    | 7         |
| <b>OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AKK-së.....</b>                                                                                          | <b>8</b>  |
| 1. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale dhe administrative në funksion të zbatimit të Ligjit të Konkurrencës;.....                    | 8         |
| 2. Promovimi i politikave të konkurrencës; dhe .....                                                                                  | 8         |
| 3. Realizimi i obligimeve që dalin nga procesi i Integrimit Evropian. ....                                                            | 8         |
| <b>OBJEKTIVI -I- FUQIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE DHE ADMINISTRATIVE NË FUNKSION TË ZBATIMIT TË LIGJIT TË KONKURRENCËS; .....</b> | <b>8</b>  |
| <b>OBJEKTIVI -II- PROMOVIMI I POLITIKAVE TË KONKURRENCËS.....</b>                                                                     | <b>10</b> |
| Promovimi dhe vetëdijesimi për politikat e konkurrencës .....                                                                         | 10        |
| BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT .....                                                                                                       | 11        |
| ANGAZHIMET TONA PËR 2020 - 2023: .....                                                                                                | 12        |
| <b>OBJEKTIVI-III-REALIZIMI I OBLIGIMEVE QË DALIN NGA PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN.....</b>                                           | <b>12</b> |
| ZBATIMI I KAPITULLIT 8 TË MSA-SE.....                                                                                                 | 13        |
| <b>MBËSHTETJA E DONATORËVE .....</b>                                                                                                  | <b>14</b> |
| <b>SHTOJCAT: .....</b>                                                                                                                | <b>15</b> |
| <b>STRUKTURA ORGANIZATIVE.....</b>                                                                                                    | <b>16</b> |

## FJALA E KRYETARIT

Valon PRESTRESHI

Kryetar, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Është evidente se ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë, në tërë botën funksionon më së miri. Ekonomia e Republikës së Kosovës ka kaluar nga një ekonomi e planifikuar, në një ekonomi të tregut, duke synuar rritjen e kapaciteteve eksportuese e rrjedhimisht uljen e deficitit tregtar.

Për të siguruar se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e Republikës së Kosovës, konkurrojnë në mënyrë të drejtë dhe të besueshme ndërmjet njëra tjetrës, e të cilat nuk i bashkërendojnë aktivitetet e tyre ekonomike, që të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në ç'rregullimin dhe shtrembërimin e konkurrencës tregtare, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka hartuar dhe miratuar **LIGJIN Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**, dhe bashkë me këtë Ligj ka krijuar institucionin e pavarur në bazë të këtij ligji, Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, për t'i parandaluar dhe ndaluar këto sjellje jo legale të ndërmarrjeve të ndryshme.

Fillimisht, dua të potencoj faktin se konkurrenca e drejtë është forma më e mirë e mbrojtjes së konsumatorit, andaj duke i luftuar në mënyrë efektive kartelet dhe praktiket e bashkërenduara të ndërmarrjeve në treg, ne si institucion synojmë që të mbrojmë konkurrencën e drejtë dhe të ju sigurojmë konsumatorëve çmime më të ulëta dhe zgjedhje më të mëdha.

Në një mjedis konkurrues, mundësohet një zhvillim më i qëndrueshëm ekonomik. Konkurrenca po ashtu nxit inovacionin, andaj ndërmarrjet që janë në gjendje të konkurrojnë mund të krijojnë dhe sigurojnë vende të reja dhe të qëndrueshme të punës.

Një kujdes të veçantë Autoriteti i kushton komunikimit me grupet e ndryshme të interesit dhe autoritetet e rëndësishme të shtetit. Në çdo rast veç e veç kujdesemi që komunikimi me publikun të jetë sa më transparent dhe i përshtatur në përputhje me karakteristikat kryesore të çdo grupi interesi.

Misioni unik i Autoritetit si garantues i konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, do të mbetet prioriteti madhor i punës sonë për vitin 2020 - 2023. Autoriteti do të mbetet një avokat i përkushtuar i konkurrencës së lirë dhe interesave të konsumatorit duke besuar se vetëm në këtë mënyrë do të përmbushë synimin final për më shumë zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë.

Ju faleminderit.

## HYRJE

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 07 nëntor 2008, në bazë të Ligjit për Konkurrencën Nr.2004/36.

Autoriteti është person juridik me autorizime publike i cili në mënyrë të pavarur i kryen punët duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-226. Autoriteti për punën e tij raporton në Kuvendin e Kosovës në baza vjetore. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është organ kolegjal që menaxhon me punën e Autoritetit, përbëhet nga pesë (5) anëtarë, Kryetari i Komisionit dhe zv.Kryetari.

Kryetari i Komisionit udhëheq, organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e Autoritetit dhe është përgjegjës për punën profesionale të Autoritetit. Sekretariati i AKK-së është një organ administrativ që ka kompetenca ligjore për të hetuar rastet dhe pas hetimeve harton raporte që i'u dorëzohen Komisionit për vendimmarrje.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Politika e konkurrencës është një element i domosdoshëm i një tregu të lirë, që funksionon duke siguruar që të gjitha ndërmarrjet konkurrojnë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë në bazë të meritave të tyre.

Qëllimi i përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, mbështetet në tri shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës:

- Marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve
- Abuzimin me pozitën dominuese; dhe
- Bashkimet ose përqendrimit e ndërmarrjeve,

Ky institucion e koncepton funksionimin e tij si nxitës dhe avokues i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit dhe bizneseve, me synimin final që tregu të gjeneroj zhvillim.

Krahas vizionit dhe misionit janë përzgjedhur edhe vlerat dhe parimet të cilat e karakterizojnë Autoritetin e Konkurrencës: **Transparenca dhe bashkëpunimi, Integriteti dhe paanshmëria, Cilësia, Efikasiteti dhe efektiviteti.**

Boshti kryesor i kësaj strategjie janë objektivat strategjike të përzgjedhura me kujdes të veçantë si synime për periudhën 2020 - 2023, e këto janë:

1. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale dhe administrative në funksion të zbatimit të Ligjit të Konkurrencës;
2. Promovimi i politikave të konkurrencës; dhe
3. Realizimi i obligimeve që dalin nga procesi i Integritetit Evropian.

Qëllimi është që AKK të jetë një autoritet modern i konkurrencës, me një strukturë organizative funksionale, të siguroj performancë solide, zbatim të drejtë të Ligjit, kënaqshëmeri të ndërmarrësve në kushtet e një tregu konkurrues, nxitje të zhvillimit ekonomik dhe të papenguar. Konkurrenca është një kontribues kryesor në rritjen ekonomike.

Zbatimi i Strategjisë së AKK-së do të shoqërohet me plan veprimi për të promovuar parimet e konkurrencës së lirë dhe për të plotësuar zbrazëtirat ligjore për kompletimin e kornizës ligjore në kuadër të përafrimit me *acquis* të BE-së.

Autoriteti do të thelloj bashkëpunimin ndërmjet rregullatorëve të sektorëve, për të siguruar që konkurrenca të respektohet gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave shtetërore që rregullojnë sektorët kryesorë të ekonomisë.

Përmes avokimit, Autoriteti do të siguroj më shumë mbështetje për punën e tij. Promovimi dhe avokimi për një treg më konkurrues, me theks të veçantë duke bërë hartimin e udhëzuesve të avancuar në arritjen e objektivave.

Në mënyrë të veçantë, angazhimet tona për periudhën 2020 - 2023, do të fokusohen në Hartimin e një **plani të veprimit për promovimin e politikës së konkurrencës** dhe Ofrimin e ekspertizës dhe këshillave për politikën e konkurrencës, për qeverinë dhe institucionet tjera.

Autoriteti i Konkurrencës gëzon mbështetje edhe nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtar, me projektet aktuale dhe të planifikuara të donatorëve.

Krahas shumë aktiviteteve është bërë edhe SWOT Analiza për AKK-në, janë marr në konsideratë Raportet e KE dhe projektit që mbështet punën e Autoritetit të Konkurrencës.

## Vizioni

Vizioni i Autoritetit është të siguroj dhe promovoj konkurrencë të lirë dhe efektive, që t'i inkurajoj ndërmarrjet të rrisin efikasitetin dhe inovacionin, duke nxitur zhvillimin e vazhdueshëm ekonomik, që konsumatori të përfitoj nga një treg konkurrues.

## Misioni

Misioni i Autoritetit është të zhvilloj aktivitete në krijimin e kushteve që tregjet të ofrojnë më shumë përfitime për konsumatorët, bizneset dhe shoqërinë në tërësi, duke mbrojtur konkurrencën në treg dhe duke promovuar një kulturë të konkurrencës në Kosovë. Autoriteti e bën këtë duke zbatuar rregullat e konkurrencës dhe përmes veprimeve, që synojnë të sigurojnë konkurrencën e drejtë, në mes të interesave të autoriteteve tjera publike. Politika e konkurrencës është një element i domosdoshëm i një tregu të lirë, që funksionon duke siguruar që të gjitha ndërmarrjet konkurrojnë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë në bazë të meritave të tyre.

Kjo reflektohet edhe me qëllimin e përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, duke u mbështetur në tri shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës:

- Abuzimin me pozitën dominuese;
- Marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve dhe
- Bashkimet ose përqendrimit e ndërmarrjeve,

Ky institucion e koncepton funksionimin e tij si nxitës dhe avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit dhe bizneseve, me synimin final që tregu të gjeneroj zhvillim.

## VLERAT DHE PARIMET E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

### Transparenca dhe bashkëpunimi

Përmes formave të ndryshme të komunikimit ne angazhohemi duke prezantuar aktivitetet dhe të arriturat e Autoritetit me palët e interesit dhe publikun, duke theksuar përfitimet e konkurrencës për konsumatorët, bizneset dhe efektin në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

Ne punojmë me partnerët tanë për të çuar përpara konkurrencën dhe për të promovuar një treg që funksionon me efikasitet.

### Integriteti dhe paanshmëria

Ne veprojmë me integritet dhe ndershmëri në mënyrë të paanshme dhe në interes të publikut. Kjo kërkon një qasje të bazuar në parime për zbatimin e Ligjit të Konkurrencës. Vendimet tona bazohen në fakte, prova dhe vlerësim të drejtë. Ne jemi të përkushtuar të mbrojmë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm.

### Cilësia


Synojmë cilësi më të lartë në vlerësimin juridik, analizën ekonomike dhe ndarja e njohurive me Institucionet tjera, partnerët dhe palët e interesuara për të përmirësuar cilësinë e vlerësimit.

### Efikasiteti dhe efektiviteti

Promovimi i veprimeve për të siguruar rëndësinë e rezultatit në treg, po ashtu jep siguri të plotë procedurale për palët, si dhe efektivitet në koston e përdorimit të burimeve.

Kemi përzgjedhur këto vlera sepse konsiderojmë se pasqyrojnë gjërat që ne besojmë se janë më të rëndësishme, angazhohemi të zbatojmë misionin dhe të arrijmë vizionin tonë. Dëshirojmë që këto vlera të jenë të dukshme në çdo gjë që bëjmë në punën tonë.

## OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AKK-së



1. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale dhe administrative në funksion të zbatimit të Ligjit të Konkurrencës;
2. Promovimi i politikave të konkurrencës; dhe
3. Realizimi i obligimeve që dalin nga procesi i Integritetit Evropian.

### OBJEKTIVI -I- FUQIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE DHE ADMINISTRATIVE NË FUNKSION TË ZBATIMIT TË LIGJIT TË KONKURRENCËS;

Qëllimi kryesor i këtij objekti është forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të AKK-së për të lehtësuar nivelin e performancës dhe rritjen e numrit të vendimeve të bazuara mirë në ligjin e konkurrencës. Për më tepër, kapaciteti funksional dhe pavarësia operationale e AKK-së duhet të rritet. Aktivitetet në kuadër të këtij objekti synojnë të përmirësojnë kapacitetet e përgjithshme institucionale dhe administrative të AKK-së në mënyrë që ajo të jetë në pozitë të zbatojë rregullat e konkurrencës në mënyrë efektive, efikase dhe transparente.

AKK do të shqyrtojë **strukturën organizative, performancën dhe aftësimin e zyrtarëve** të Autoritetit për të siguruar një **Program Trajnimi** që do të shërbejë si bazë




për zbatim. Kjo do të lejojë fleksibilitet në përgatitjen dhe zbatimin e trajnimeve, për t'i përshtatur ato sipas nevojave specifike që mund të lindin gjatë zbatimit.

Qëllimi është që AKK të jetë një **autoritet modern i konkurrencës**, ku ekzistojnë mandatet, strategjia, procesi i vendimmarrjes, funksionaliteti, procedurat standarde të operimit, plani i burimeve njerëzore, objektivat dhe treguesit kryesorë të performancës ku mund të monitorohen rregullisht përmes përdorimit të IT-së dhe ky informacion i prodhuar / trajtuar nga institucioni mund të jetë në dispozicion në kohë reale. Pjesë e këtij objekti do të jetë edhe një **plan veprimi për të identifikuar zbrazëtirat ligjore** për kompletimin e kornizës ligjore në kuadër të përafrimit me *acqiste* BE-së.

Autoriteti do të bëjë **analiza sektoriale** të cilat janë një mjet themelor për zbatimin e rregullave të konkurrencës, pasi ato i mundësojnë AKK-së që të njihet me aplikimin e rregullave të konkurrencës në një sektor të caktuar të ekonomisë duke shikuar në strukturën institucionale, vendosjen e legjislacionit, karakteristikat e strukturës së tregut, kufizimet e kapaciteteve, investimet, pengesat për qasje të akterëve të rinjë në treg, praktikat e përbashkëta tregtare, çmimet etj. Këto analiza do t'i ofrojnë AKK-së një pasqyrë të gjendjes së konkurrencës në tregje specifike që rezultojnë me rekomandime për ndryshimin e legjislacionit ekzistues ose në disa raste hetime për shkeljet e konkurrencës.

Realizimi i këtij objekti do të zbatohet përmes këtyre aktiviteteve:



## OBJEKTIVI -II- PROMOVIMI I POLITIKAVE TË KONKURRENCËS

Zbatimi i konkurrencës duhet të jetë rezultat i një përpjekjeje të bashkërenduar në nivelin qeveritar, pasi konkurrenca zbatohet horizontalisht në të gjithë sektorët e ekonomisë. Ky objektivi, pra, synon krijimin ose forcimin në Kosovë të një koordinimi të tillë vis-à-vis ministritë e linjës, rregullatorët e sektorit, agjencitë qeveritare dhe institucionet e tjera relevante të cilat do të jenë përfituesit kryesorë të këtij objektivi së bashku me AKK-në.

Autoriteti do të thelloj bashkëpunimin ndërmjet rregullatorëve të sektorëve për të siguruar që konkurrenca të respektohet gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave shtetërore që rregullojnë sektorët kryesorë të ekonomisë.

Koordinimi në lidhje me rregullimin ekonomik mund të prekë përcaktimin përkatës të tregut, identifikimin e kompanive që kanë fuqi të rëndësishme tregu, identifikimin e mjeteve juridike për të nxitur konkurrencën *ex ante* ose *ex post*, shkëmbimin e të dhënave, duke përfshirë informacionin konfidencial, mendimet profesionale, rekomandime, opinionet, shkeljet, etj.

Një qëllim tjetër i këtij objektivi është arritja e harmonizimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe bashkëpunimit me autoritetet publike.

Autoriteti do të angazhohet që të japë propozimin e ndryshimeve për të siguruar përputhshmërinë me ligjin dhe parimet e konkurrencës, duke ruajtur, në masën e mundshme, objektivin e politikës së njëjtë.

### Promovimi dhe vetëdijesimi për politikat e konkurrencës

Autoriteti do të angazhohet në promovimin e kulturës së konkurrencës në të gjitha nivelet, duke përfshirë Institucionet shtetërore, Gjykatat, Bizneset, Universitetet, Oda e avokatëve, Shoqatat e konsumatorëve, OJQ-të dhe Mediat duke ngritur nivelin e informimit për rolin e konkurrencës së tregut të drejtë dhe për llojet e ndryshme të shkeljeve të konkurrencës.

Ky objektivi gjithashtu përfshin aktivitete që lidhen me prezencën e AKK-së si një institucion, nëpërmjet përdorimit të mediave.

Përmes avokimit, Autoriteti do të siguroj më shumë mbështetje për punën e tij. Promovimi dhe avokimi për një treg më konkurrues, me theks të veçantë duke bërë hartimin e udhëzuesve të avancuar në arritjen e objektivave.

Konkurrenca është një kontribues kryesor në rritjen ekonomike. Konsumatorët kosovar kanë shfaqur interes për një konkurrencë më të fortë dhe më shumë zgjedhje përmes miratimit të shpejtë të produkteve dhe shërbimeve inovative në sektorët e rregulluar dhe jo të rregulluar. Autoriteti promovon politikën e konkurrencës në mënyrë që modelet inovative të biznesit të inkurajohen. Kjo është mundësi për rritje të vazhdueshme ekonomike duke u ofruar konsumatorëve çmime më të ulëta, shërbime më të mira dhe cilësi më të lartë të produkteve.


## BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT

Autoriteti do të vazhdoj përpjekjet e bashkëpunimit duke forcuar partneritetet me autoritetet tjera të konkurrencës. Duke qenë pjesë e procesit të integritetit evropian, anëtar në Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN), UNCTAD, Qendra Regjionale për Konkurrencë (RCC), Forumi i Konkurrencës Sofje (SCF), si pjesë e procesit të bashkëpunimit mes autoriteteve të konkurrencës në rajon, do të jetë i angazhuar në forcimin e bashkëpunimit dhe vendosjen mbi baza institucionale.

**Nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit** me Autoritetet e tjera simotra si dhe pjesëmarrja në organizime të tilla shumëpalëshe do të nxisin bashkëpunim më të madh dhe zhvillojnë praktikën më të mira.


Ngritja e nivelit të zbatimit të Ligjit të Konkurrencës do të jetë një mundësi e mirë për promovimin e një ambienti i cili do të jetë atraktiv për investitorët e huaj në Kosovë.

## ANGAZHIMET TONA PËR 2020 - 2023:



Në mënyrë që Autoriteti të promovoj një kulturë të konkurrencës përmes avokimit, së pari duhet të sigurohet që stafi të ketë aftësi adekuate për ta bërë këtë. Të gjitha aktivitetet që do të zbatohen nën këtë objektiv do të marrin në konsideratë edhe bartjen e aftësive drejt stafit të AKK-së.

Aktivitetet për realizimin e këtij objektiv do të zhvillohen përmes **organizimit të seminareve, punëtorive të ndryshme, ligjëratave në Universitete, paraqitjes së aktiviteteve në web faqen e Autoritetit, rrjeteve sociale, paraqitjes mediale të zyrtarëve të AKK-së, përgatitjes dhe shtypjes së materialeve promovuese, etj.**



### OBJEKTIVI-III-REALIZIMI I OBLIGIMEVE QË DALIN NGA PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN

Anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian (BE) është objektivi më i rëndësishëm strategjik i vendit. BE përfaqëson bashkimin politik dhe ekonomik më të madh në botë, që promovon standarde dhe vlera, të cilat përputhen me aspiratat e vendit tonë. Integrimi në BE konsiderohet në radhë të parë si një proces që është i lidhur me përmbushje standardesh dhe plotësim kriteresh.

## ZBATIMI I KAPITULLIT 8 TË MSA-SË

Marrëveshja e MSA-së ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi, më **1 Prill 2016**. Ky program ka për qëllim zbatimin e të gjitha reformave për adoptimin e acquis së BE-së në legjislacionin kombëtar në të gjithë kapitujt e saj.


Në kuadër të MSA-së, kapitulli 8 i kushtohet Konkurrencës që përfshinë politikat e konkurrencës dhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore.

Kapitulli përmban legjislacion, rregulla dhe procedura për sjelljen jo-konkurruese të ndërmarrjeve siç janë marrëveshjet e ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve, dhe abuzimi me pozitën dominuese në treg.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në anën tjetër, në mënyrë eksplicite vendosë një sërë obligimesh për Kosovën, të përfshira në Titullin VI, përkatësisht nga **Nenet 74 - 75 të MSA-së**.

Marrëveshja synon në përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me Acquis, zbatimin efektiv si dhe sigurimin e mekanizmave të monitorimit dhe transparencës kompatibil me rregullat e BE-së.

Në esencë, kjo ka të bëjë me:



Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës gjatë punës duhet të merr parasysh edhe kërkesat që dalin nga mekanizmat tjerë të aderimit në BE, si: raportet vjetore të KE-së për Kosovën, konkluzionet nga takimet e Komiteteve dhe Nën komiteteve për Treg të Brendshëm, Konkurrencë dhe Mbrojtje të Konsumatorit.

Krahas MSA-së zbatohet edhe Agjenda për Reforma Evropiane (**ERA**), e cila parasheh prioritetet e nivelit politik dhe reformat konkrete për përmbushjen e tyre, dhe si e tillë është e ndërlidhur me këtë program.

## MBËSHTETJA E DONATORËVE

Institucionet e Kosovës mbështeten nga Komisioni Evropian (përmes IPA-s) dhe nga donatorët tjerë bilateral me projektet e përmbledhura në vijim.

Projektet aktuale dhe të planifikuara të donatorëve për Autoritetin e Konkurrencës:

- ✓ Projekti i BE-së në kuadër të IPA II 2014-2020 për **“Asistencë Teknike për Mbështetje për Autoritetin e Konkurrencës dhe Komisionin e Ndhmës Shtetërore”** ka filluar në vitin 2019 dhe do të zgjasë deri me 2021, me një kosto të përgjithshme prej rreth 3 milion euro.
- ✓ **Projekti i binjakëzimit me Lux Development**, nga ky projekt Autoriteti do të marrë trajnime në fushën e **Analizës së Tregut**.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, duke qenë anëtar në Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN), UNCTAD, Qendrën Regjionale për Konkurrencë (RCC), Forumin e Konkurrencës Sofje (SCF), ka rol të rëndësishëm në procesin e integritetit evropian. Si pjesë e procesit të bashkëpunimit mes autoriteteve të konkurrencës në rajon, do të jetë i angazhuar në forcimin e bashkëpunimit me autoritetet tjera të konkurrencës me synim nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit me Autoritetet tjera simotra si dhe pjesëmarrja në organizime shumë palëshe në funksion të nxitjes së bashkëpunimit dhe zhvillimit të praktikave më të mira.



## SHTOJCAT:


### 1. SWOT - Analiza

| PËRPARËSITË:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | DOBËSITË:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pavarësia institucionale,</li> <li>2. Transparenca me publikun,</li> <li>3. Përkushtimi në zbatimin profesional dhe efektiv të LMK,</li> <li>4. Stafi i ri dhe i zellshëm,</li> <li>5. Kredibiliteti dhe përvoja në trajtimin e rasteve,</li> <li>6. Promovimi i kulturës së konkurrencës.</li> </ol>                                                                                                                                        | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kapacitetet e pamjaftueshme,</li> <li>2. Legjislacioni i pakompletuar,</li> <li>3. Mungesa e ekspertizës dhe njohurive specifike për konkurrencën,</li> <li>4. Bashkëpunimi i pamjaftueshëm me grupet e interesit,</li> <li>5. Nivel i ultë i zbatimit të mendimeve profesionale ,</li> <li>6. Mungesa e njohurive për Konkurrencën nga Gjykatat e Kosovës.</li> <li>7. Buxheti i pamjaftueshëm për zhvillim të aktiviteteve,</li> <li>8. Mungesa e hapësirave të punës,</li> <li>9. Mungesa e një aplikacioni softwerik,</li> <li>10. Mungesa e vizibilitetit në opinion,</li> <li>11. Mungesa e zyrës për marrëdhënie me publikun,</li> </ol> |
| MUNDËSITË:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | RREZIQET:                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja profesionale duke shfrytëzuar projektet për përkrahje të AKK-së,</li> <li>2. Ngritja e nivelit të vetëdijësimit për konkurrencën nga akterët tjerë</li> <li>3. Rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional</li> <li>4. Thellimi i njohurive nga gjykatat për çështjet e konkurrencës përmes projekteve që përkrahin AKK-në,</li> <li>5. Rritja e rolit të AKK-së përmes mendimeve profesionale, rekomandimeve dhe opinioneve</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Humbja e pavarësisë institucionale (Ligji për Administratë Shtetërore),</li> <li>2. Ndryshimet e mundshme në politikën qeveritare,</li> <li>3. Mungesa e përkrahjes nga Institucionet,</li> <li>4. Shpenzimi i buxhetit në mënyrë jo të drejtë,</li> </ol>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |

## STRUKTURA ORGANIZATIVE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës  
 Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



KOMISIONI I  
 AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS

Valon Prestreshi  
 Kryetar

Ahmet Krasniqi  
 Zëvendëskryetar

Fatime Haziri  
 Anëtare

Muhamed Krasniqi  
 Anëtar

Shaqir Morina  
 Anëtar